

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJILAN, DEGA NË NOVOBËRDË-

Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarës Emine Salihu, me Ref. e lartë Mimoza Mehmeti, në lëndën penale kundër të akuzuarit Z. V., nga Gjilani, për shkak të veprës penale Vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 nën paragrafi 1.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan- Departamenti i përgjithshëm PP.II-nr.1121/2017 të datës 24.07.2017, të cilën e përfaqsonte prokurorja e shtetit Leonora Kadriu, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar më datë 21.12.2020, në prezencë të palëve mori dhe shpalli këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri Z. V., pa pseudonim dhe emër të rrejshëm, nga i ati S., dhe e ëma S., e lindur L., i lindur më dt., në Fsh.M. e . K.Gjilan, me vendbanim të përhershëm ne Gjilan, Rr”....”, nr....., i pa martuar, ka të kryer shkollën fillore, i papunë, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i pa dënuar dhe nuk udhëhiqet procedurë për ndonjë vepër tjetër penale.

Është fajtor

Sepse ,

-Mes datës 21/22.05.2017, në kohë të papërcaktuar, në Fshatin Z., K.Novobërdës, i pandehuri me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për vete ka kryer vjedhje të rëndë në dëm të të dëmtuarit Z. S., në atë mënyrë që me forcë ka hapur dritaren e shitores, ka hy brenda dhe ka marrë: cigare, qokollada, të holla metalike në euro, si dhe disa të holla të letrës në dinare, me qka sipas të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm material në vlerë rreth 100(njëqind) euro.

- me çka ka kryer veprën penale Vjedhja e rëndë nga neni 327 par.1 nën paragrafi 1.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata duke u bazuar në dispozitat e cituara ligjore ,nenin 4, 41, 43, 45, 46, 49, 73, 75, si dhe nenin 365 të KPRK-së, dhe nenin 451 të KPPK-ës të akuzuarit, i shqipton:

E G J Y K O N

Ashtu që të akuzuarit Z. V., ti caktohet dënimi me gjobë në shumë prej 300 Euro (Tre qind Euro), si dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve të cilat dënime i pandehuri nuk do ti vuaj nëse në afat prej 1 viti nga dita kur aktgjykimi të bëhet i formës së prerë, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale e në të kundërtën gjykata do t'ia revokoj dënimin me kusht.

I dëmtuari Z. S., nga Fsh.Z., K.Novobërdës, për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Obligohet i akuzuari ti paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 25 (njëzetë e pesë) Euro, si dhe në emër të hargjimeve procedurale shumë e përlllogaritur në llogarinë përfundimtare të kësaj gjykate, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në konform të nenit 39 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 të Ligjit për kompenzimin e viktimave të krimit i pandehuri Z. V., obligohet të paguajë taksën në shumë prej 30 ero.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.1121/2017 të datës 24.07.2017, ndaj të pandehurit Z. V., nga Gjilani, për shkak të veprës penale Vjedhja e rëndë nga neni 327 par.1 nën paragrafi 1.1 të KPRK-së.

I pandehuri Z. V., ka deklaruar : se aktakuzën e lexuar nga ana e prokurores së shtetit e kam kuptuar në tërësi, e ndiej vehtën fajtor dhe e pranoj fajsinë, është hera e parë që ndeshem me ligjin, i premtoj gjykatës se një veprim të tillë nuk do ta përsërisë dhe kërkoj nga gjykata që të më shqiptoj një dënim sa më të butë. Beto hem publikisht edhe para gjykatës se kjo do të jetë hera e parë dhe e fundit që merrem me vepra të tilla meqë tani vuaj dënimin në Dubravë, për dy vepra penale të natyrës së njëjtë, rrënjësisht me shpirt po e ndiej pasaojat e kryerjes së kësaj vepre penale dhe qka do të thotë kryerja e veprave të tilla. Publikisht i kërkoj falje të dëmtuarit prezent në gjykatore të cilin nuk e kam njohur por për nevojat e mia personale, kam gabuar dhe i kam vjedhur në shitoren e tij sendet e përmendura në dispozitivin e akuzës.

Prokurorja e shtetit Leonora Kadriu, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar të datës 21.12.2020, deklaroj: se nuk e kundërshtoj pranimin e fajesisë nga ana e të akuzuarit.

Pas dëgjimit të prokurores së shtetit dhe të akuzuarit, gjyqtarja e vetme gjykuese konstatoi se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore, nga neni 248 paragrafi 2 të KPP për pranimin e fajsisë, nga se i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, se pranimi është bërë vullnetarisht nga i

pandehuri, pranimi mbështetet nga faktet e çështjes nga aktakuza e cila nuk përmban as një shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Andaj ,duke u bazuar në këtë që u cekën më lartë, gjykata e vërtetoi gjendjen faktike :

Se i pandehuri Z. V.i, nga Gjilani, e ka kryer veprën penale Vjedhja e rëndë nga neni 327 par.1 nën paragrafi 1.1 të KPRK-së.

Gjyqëtarja e vetëme gjykuese, shpalli fajtor të pandehurin Z. V., për veprën e cekur më lartë nga se veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtën është edhe përgjegjës penalisht.

Me rastin e matjes së dënimit të pandehurit gjykata ia ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit ,sipas nenit 73,të KPRK-së ku si rrethanë veçanarishtë lehtësuese gjykata e ka marrë për bazë faktin se i pandehuri e ka pranuar fajsinë, sjelljen korrekte në gjykatë ,ka shprehur keqëardhje për kryerjen e kësaj vepre , është penduar, i ka kërkuar falje publike të dëmtuarit.

Sipas bindjes së kësaj gjykate, caktimi i dënimit me kusht ndaj të pandehurit Z. V., është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit, si dhe me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit ,nga neni 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 451 të KPRK-së.

Vendimi për kërkesën pasurore është marrë duke u bazuar në nenin 463 paragrafi 1.2 të KPPRK-së.

Nga të cekurat e më sipërme e në bazë të nenit 365 të KPPK-ës,u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi .

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN ,DEGA NË NOVOBËRDË

Departamenti i përgjithshëm

P.nr.56/2017

Më:21.12.2020

*Ref. e lartë
Mimoza Mehmeti*

*Gjyqtarja
Emine Salihu*

KËSHILLA JURIDIKE :*Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në gjykatën e Apelit në Prishtinë ,në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit .Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj gjykate.*

Pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar më datë 21.12.2020,pas vendosjes, gjyqtarja në presencë të palëve publikisht shpalli këtë:

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJILAN, DEGA NË NOVOBËRDË-
Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtares Emine Salihu, me Ref. e lartë Mimoza Mehmeti, në lëndën penale kundër të akuzuarit Zeqir Vokshi, nga Gjilani, për shkak të veprës penale Vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 nën paragrafi 1.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan- Departamenti i përgjithshëm PP.II-nr.1121/2017 të datës 24.07.2017, të cilën e përfaqsonte prokurorja e shtetit Leonora Kadriu, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar më datë 21.12.2020, në prezencë të palëve mori dhe shpalli këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri Zeqir Vokshi, pa pseudonim dhe emër të rrejshëm, nga i ati Selami, dhe e ëma Selvie, e lindur Leka, i lindur më dt. 23.04.1997, në Fsh.Malishevë e Epërme, K.Gjilan, me vendbanim të përhershëm ne Gjilan, Rr"Avdulla Presheva", nr.143, i pa martuar, ka të kryer shkollën fillore, i papunë, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i pa dënuar dhe nuk udhëhiqet procedurë për ndonjë veprë tjetër penale.

Është fajtor

Sepse ,

-Mes datës 21/22.05.2017, në kohë të papërcaktuar, në Fshatin Zebincë, K.Novobërdës, i pandehuri me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për vete ka kryer vjedhje të rëndë në dëm të të dëmtuarit Zoran Stojkoviq, në atë mënyrë që me forcë ka hapur dritaren e shitores, ka hy brenda dhe ka marrë: cigare, qokollada, të holla metalike në euro, si dhe disa të holla të letrës në dinare, me qka sipas të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm material në vlerë rreth 100(njëqind) euro.

- me çka ka kryer veprën penale Vjedhja e rëndë nga neni 327 par.1 nën paragrafi 1.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata duke u bazuar në dispozitat e cituara ligjore ,nenin 4, 41, 43, 45, 46, 49, 73, 75, si dhe nenin 365 të KPRK-së, dhe nenin 451 të KPPK-ës të akuzuarit, i shqipton:

E G J Y K O N

Ashtu që të akuzuarit Zeqir Vokshi, ti caktohet dënimi me gjobë në shumë prej 300 Euro (Tre qind Euro), si dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve të cilat dënime i pandehuri nuk do ti vuaj nëse në afat prej 1 viti nga dita kur aktgjykimi të bëhet i formës së prerë, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale e në të kundërtën gjykata do t'ia revokoj dënimin me kusht.

I dëmtuari Zoran Stojković, nga Fsh. Zebincë, K. Novobërdës, për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Obligohet i akuzuari ti paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 25 (njëzetë e pesë) Euro, si dhe në emër të hargjimeve procedurale shumë të përlogaritur në llogarinë përfundimtare të kësaj gjykate, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në konform të nenit 39 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 të Ligjit për kompenzimin e viktimave të krimit i pandehuri Zeqir Vokshi, obligohet të paguajë taksën në shumë prej 30 ero.

*Ref. E larte
Mimoza Mehmeti*

*Gjyqtarja
Emine Salihu*

Gjyqtarja pasi lexoi dispozitivin e aktgjykimit, në prani të palëve, në seancë të hapur, shkurtimisht prezantoi arsyerat e aktgjykimit.

Pas shshpalljes së aktgjykimit, gjyqtarja në kuptim të nenit 368 të KPP i udhëzon palët për të drejtën në ankesë.

Se kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit, me shkrim përmes kësaj gjykate.

Gjyqtarja, gjithashtu njoftoi palët për detyrimet e tyre se deri në përfundim të procedurës ta njoftoj gjykatën për çdo ndryshim të adresës.

Vërtetojnë:

*Ref. e lartë
Mimoza Mehmeti*

*Gjyqtarja
Emine Salihu*